

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"KOSTA & PARTNERS" SH. P.K.**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (*këtu e në vijim referuar si LSHT*), nënshkruesit e këtij dokumenti, vendosën si më poshtë vijon:


**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Baza ligjore**

1. Hartimi i Aktit të Themelimit dhe Statutit bazohet dhe respekton kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (*këtu e në vijim referuar si LSHT*) dhe legjislacionit civil në fuqi.
2. Dispozitat e Statutit kanë karakter të detyrueshëm dhe rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë me Ortakët dhe organet e saj si dhe marrëdhëniet mes ortakëve. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë dokument, rregullohen sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar.

**Neni 2  
Përkufizime**

1. Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
  - a) "**Shoqëria**" nënkupton shoqërinë tregtare të themeluar sipas këtij dokumenti, me emrin e përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti dhe të ndryshuar sipas rastit, në përputhje me kërkesat e Statutit dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.
  - b) "**Statuti**" nënkupton statutin e Shoqërisë.
  - c) "**Ortak(ët)**" Sipas rastit, themeluesit e Shoqërisë ose personat fizikë dhe/ose juridikë që zotërojnë kuotat e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti;
  - d) "**Person**" është çdo person fizik apo juridik;
3. Në këtë Statut, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, dhe gjinia mashkullore përfshin edhe atë femërore dhe anasjelltas.



**Neni 3**  
**Komunikimet**

1. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikime që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit (ëve) të Shoqërisë duke përfshirë dhe komunikimet me mjete elektronike nëse këto të fundit garantojnë konfirmimin e marrjes dhe sigurinë e komunikimit.
2. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikimet e dërguara sipas paragrafit të mësipërm, do të konsiderohen rregullisht të marra nga Ortaku në datën më të hershme midis: (i) datës së marrjes efektive nga Ortaku, (ii) datës së pranimit apo refuzimit të shënuar në njoftimin e marrjes nëse dërgohet me postë të regjistruar; ose (iii) brenda 72 orësh nga dorëzimi pranë një shërbimi të shpejtë postar të njohur ndërkombëtarisht.

**KREU II**  
**THEMELIMI**

**Neni 4**  
**Data e themelimit, Themeluesit dhe Emri**

1. Sot, më datë **21/10/2021**, ne themeluesit, krijojmë një Shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
2. Emri i Shoqërisë është "**Kosta & Partners**" Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin "**Kosta & Partners**" Sh.p.k. (këtu e në vijim: "*Shoqëria*"). Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
3. Themeluesit e Shoqërisë janë:  
**Znj. Anxhela Kosta**, e bija e Odhise, lindur në Përmet, Shqipëri, më 25.07.1995 dhe banuese në Rrugën Panajot Pano, Nd.6, H.45, Ap.40, Kashar, Yzberisht, Tiranë, shtetase shqiptare, identifikuar me kartën e identitetit me nr. J55725071U, madhore dhe me zotësi të plotë .  
**Z. Nicolas Marcel Adam**, i biri i Ulrich, lindur në Tettang, Gjermani, më 28.09.1988 dhe banues Alemannen-Strasse 19/2 D-88094 Oberteuringen, Gjermani, shtetas gjerman, identifikuar me kartën e identitetit me nr. L7P37ZHZX, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
5. Themeluesit e Shoqërisë deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve që vijnë, hartimin e Akt themelimit -Statutit të shoqërisë së re të së drejtës shqiptare "**Kosta & Partners**" sh.p.k. mbi bazën e ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe hartojnë këtë Statut si vijon:



**KREU III**  
**SELIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, DEGËT DHE ZYRAT E**  
**PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE**

**Neni 5**  
**Selia**

1. Selia e Shoqërisë është në adresën:“Rruga Arkitekt Sinani, Pallati 6 Katësh, Kati 5. Ap.28, Tiranë”.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë, si dhe mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të saj.

**Neni 6**  
**Objekti i Shoqërisë**

1. Shoqëria ka për objekt:
  - a. Ofrimin e shërbimeve të konsulencës ligjore në të gjitha fushat e së drejtës;
  - b. Përfaqësimin ligjor të të asistuarve në gjykata përfshirë atë kushtetuese;
  - c. Dhënie e asistence e konsulence në marrëdhënie me administratën publike me qëllim kërkimin dhe lëshimin e çdo akti në kompetence të organeve publike, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të të asistuarve.
  - d. Ndërmjetësim ligjor, përfaqësim dhe këshillim në arbitrazh, ndërmjetësim financiar dhe në fushën e sigurimeve private.
  - e. Ofrimin e shërbimeve ne fushën e Pronësisë Intelektuale, të së Drejtës së Autorit dhe Pronësisë Industriale.
  - f. Ofrimin e programeve trajnuese lidhur me çdo çështje të së drejtës.
2. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, mobiliare, imobiliare të konsideruara si të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të aktivitetit të Shoqërisë, duke saktësuar se aktiviteti financiar mund të kryhet vetëm me qëllim realizimin e objektit të Shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të blejë kuota dhe/ose aksione në Shoqëri të tjera.
3. Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të administrojë, blejë, shesë, të japë me qira si dhe të ketë interesa e pjesëmarrje në shoqëri, të themeluara apo në proces themelimi, që kanë objekt të ngjashëm me objektin e aktivitetit të Shoqërisë, ose që i

shërben realizimit të këtij objekti. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

4. Shoqëria mund të ofrojë shërbime të tjera ose të kryejë aktivitete të tjera siç vendoset përmes vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e saj të aktivitetit në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe këtij Statuti

#### **Neni 7**

#### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

1. Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është pa afat tëcaktuar.
2. Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga momenti regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB) Tiranë.

#### **Neni 8**

#### **Përgjegjësia e Ortakëve**

1. Ortakët e Shoqërisë janë Personat që kanë përfituruar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “**Kosta & Partners**” sh.p.k. dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

### **KREU IV**

#### **KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT, KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT**

#### **Neni 9**

#### **Kapitali i Shoqërisë**

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet midis Ortakëve në kuota në përputhje me kontributet përkatëse në kapital. Kontributi mund të jetë në para ose natyrë (*pasuri të luajtshme apo të paluajtshme apo të drejta të ortakëve*).
2. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është i barabartë me 1,000 (njëmijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët. Kapitali themeltar është i përbërë nga dy (2) kuota të cilat i përkasin Ortakëve:
  - 1) Anxhela KOSTA, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme prej 500 (pesëqindë) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - 2) Nicolas Marcel ADAM, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme prej 500 (pesëqindë) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë;



3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.
4. Ortakët kanë të drejtë të tërheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të Shoqërisë, në rast se Shoqëria nuk regjistrohet ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e depozitimit të fondeve.

#### **Neni 10**

#### **Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar**

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

#### **Neni 11**

#### **Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar**

1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.
2. Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ndryshe.

#### **Neni 12**

#### **Transferimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar**

1. Kuotat e kapitalit të regjistruar të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:
  - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b. shitblerjes;
  - c. trashëgimisë;
  - d. dhurimit;
  - e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Kuotat e kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
3. Transferimi i kuotave do të bëhet vetëm nëpërmjet një dokumenti në formë shkresore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.





4. Në rast të transferimit të çdo forme të kuotave (përfshirë dhe transferimin pa kundër shpërblim), tek subjekte të tretëve, transferimi do të kushtëzohet nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ortakët aktual të Shoqërisë, mbi kuotat të cilat synohet të transferohen.
5. Ortakët që synojnë të transferojnë pjesë të tyre të kapitalit pjesërisht apo plotësisht duhet t'ia komunikojnë këtë me letër rekomande ortakëve të tjerë të cilët kanë 30 ditë kohë për të komunikuar vullnetin e tyre për ushtrimin e të drejtës së parablerjes; mungesa e komunikimit brenda këtij afati do të konsiderohet si heqje dore e të drejtës së parablerjes. Në këtë rast ortaku që kërkon të largohet ka të drejtë të tranferojë tek të tretët kuotën e tij.
6. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i tranferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendin të Asamblesë së Përgjithshme sipas shumicës së përcaktuar në dispozitat përkatëse të LSHT-së.

### **Neni 13**

Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

## **KREU V ORGANET E SHOQËRISË**

### **Neni 14**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

Në bazë të ligjeve shqiptare dhe dispozitave të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët.

### **Neni 15**

#### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe këtë statut, veçanërisht në lidhje me çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - m) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - n) anulimin e kuotave;
  - o) largimin ose përjashtimin e ortakut;
  - p) ndryshimin e logos të shoqërisë, markat tregëtare;
  - q) çështje të tjera të parashikuara nga ligji nr. 9901/2008 date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar apo nga ky statut.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
  3. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
  4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 16**

#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike e-mail e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.
2. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 17**

#### **Kuorumi**

1. Në rast të marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas dispozitave të LSHT dhe këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse orakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të




kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 88 të LSHT.

3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblihet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në paragrafin e sipërm të këtij neni, Asambleja mblihet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 18**

#### **Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për të gjitha çështjet e përcaktuara nga neni 15 i këtij Statuti, Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës.
2. Në rast të vendimarrjes për ndryshimin e Statutit, Statuti i përditësuar me ndryshimet e pësuara duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të mblihet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri.

### **Neni 19**

#### **Përfashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 20**

#### **Procesverbali i Mbledhjes**

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.



2. Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverballi, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverballi i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit.
3. Procesverballit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

## **Neni 21**

### **Pjesëmarrja përmes mjeteve elektronike**

1. Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunikimit video-shkrues.
2. Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakëve, si edhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme që:
3. Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë ortakët të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbarëvajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe të shpallë rezultatin e votimit;
4. Mbajtësi i procesverbalit të ketë mundësinë për t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit;
5. Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmëve për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.
6. Mbledhja e Asamblesë në kushtet e përmendura në nenin 21.1 dhe vijues të këtij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur pavarësisht faktit se Ortakët nuk janë të pranishëm në të njëjtin vend dhe kohë të konferencës në ditën dhe kohën në të cilën konferenca mbahet apo do të konsiderohet se u mbajt pranë selisë së Shoqërisë, nëse nuk bihet dakord ndryshe, të gjithë Ortakët që marrin pjesë në mbledhje do të konsiderohet se kanë qenë të pranishëm me kusht që vendimi të nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit të cilët duhet të jenë në të njëjtin vend gjatë mbledhjes.
7. Kryetari i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.
8. Kuorumi i nevojshëm për telekonferencën do të jetë i njëjti kuorum i parashikuar në Statut për Asamblenë e Përgjithshme.
9. Në rast se ortakët janë të ftuar të marrin vendime nëpërmjet konsultimit me shkrim, kuorumi do të quhet si i formuar bazuar në numrin e ortakëve që do të dërgojnë votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose çdo Ortak i pakicës që kërkojnë vendimmarrjen duhet t'i dërgojnë çdo ortaku njoftimin për konsultimin me shkrim, i cili do të përmbajë gjithë informacionet që përfshihen në letrën e njoftimit/thirrjes të përcaktuar në këtë Statut. Procedura e konsultimit me shkrim duhet të kryhet në përputhje me përmbajtjen e këtij neni, në rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet të shprehet me shkrim në lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve në formën e dërguar nga administratori,



nëpërmjet shënimit “pro” ose “kundër” ose duke u shprehur komentet e tyre në një dokument tjetër. Në rast se ortakët kanë komente, duhet t’u bëjnë referencë të qartë projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t’i dërgojë Administratorit ose ortakëve që kanë kërkuar marrjen e vendimit nëpërmjet këshillimit me shkrim, votën e tij/vendimet me shkrim brenda datës së përcaktuar në njoftimin e dërguar për marrjen e vendimit nëpërmjet konsultimit me shkrim.

10. Vendimet e ortakëve të marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga Mbajtësi i procesverbalit. Gjithashtu ky procesverbal duhet të pasqyrojë mënyrën e organizimit të mbledhjes së asamblesë apo të konsultimit me shkrim nëse është kryer në përputhje me ligjin dhe dispozitat e Statutit, të identifikojë ortakët e pranishëm dhe të përfaqësuar ose ortakët që kanë votuar me shkrim, nëse kuorumi i ortakëve që kanë votuar me shkrim është respektuar sipas Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nëse vendimet konsiderohen të miratuara sipas rezultatit të votimeve. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari dhe Mbajtësi i procesverbalit. Procesverbalit i bashkëngjitet gjithashtu lista e ortakëve që kanë votuar (përveç rastit kur procesverbali është nënshkruar nga gjithë ortakët) si dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë të cilat mbahen në selinë e Shoqërisë. Nëse vendimet e marra nga ortakët duhet të depozitohen pranë Regjistrat Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhëna (nëpërmjet konsultimit me shkrim nga ortakët) do të shërbejnë si dokumentet që provojnë të dhënat që do të depozitohen në këtë regjistër.
11. Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të shqyrtojë në të njëjtën ditë të gjitha çështjet që duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet të nesërmen pa pasur nevojë për njoftim të mëtejshëm.

## **Neni 22** **Administratori**

1. Administratori është organi ekzekutiv i Shoqërisë.
2. Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
3. Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të Shoqërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët; të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë si dhe t’i depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Administratori do të jetë përgjegjës por pa u kufizuar për sa më poshtë:
  - a) Të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të Shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit; punësimin dhe pushimet nga puna të personelit; dhënien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në Shoqëri; mbajtjen e korrespondencës së Shoqërisë; dhënien e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj. të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë



direkte apo të tërthortë me punën e përditshme të Shoqërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e Shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të Shoqërisë; Të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të Shoqërisë si rezultat i punëve të kryera; Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari,

- b) Të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me negocimin, hartimin dhe lidhjen e çdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë apo juridikë vendas ose të huaj, me institucione apo ente të ndryshme shtetërore si dhe çdo subjekt tjetër.
- c) Të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- d) Të hartojë projekt planin e investimeve të Shoqërisë dhe ta paraqesë për miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve;
- e) Të caktojë pagat dhe shpërblimet e punonjësve dhe stafit tjetër ndihmës të shoqërisë;
- f) Të lidhë marrëveshje me palë të treta bashkëpunimi, investimi apo zhvillimi në funksion të interesit të shoqërisë;
- g) Të kryejë investime në interes të shoqërisë;
- h) Të vendosë mbi planin operacional të Shoqërisë;
- i) Të hartojë buxhetin financiar vjetor për t'u miratuar nga Asambleja e Ortakëve;
- j) Ngritjen e sistemit të administrimit të brendshëm;
- k) Të emërojë konsulentë të brendshëm e të jashtëm të fushave të ndryshme që i shërbejnë shoqërisë dhe ndihmojnë administratorin në ushtrimin e veprimtarisë të tij;
- l) Çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga Statuti i Shoqërisë.

Administratori i parë i shoqërisë është Z. Anxhela KOSTA e bija e Odhise, lindur në Përmet, Shqipëri, më 25.07.1995 dhe banuese në Rrugën Panajot Pano, Nd.6, H.45, Ap.40, Kashar, Yzberisht, Tiranë, shtetase shqiptare, identifikuar me kartën e identitetit me nr. J55725071U, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili ushtron të gjitha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 23

#### Përgjegjësia e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas

neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

- a. të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
5. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e LSHT-së, kryen veprimet e mëposhtme:
- a. u kthen ortakëve kontributet;
  - b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e. jep kredi.
7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



**Neni 24**  
**Marrëdhëniet e punës**

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi.
2. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj.
3. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 25**  
**Konfidencialiteti dhe Ruajtja e sekretit**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Shoqërisë.

**KREU VI**  
**EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA**  
**E FITIMEVE**

**Neni 26**  
**Eksperti kontabël**

Kur është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

**Neni 27**  
**Viti financiar dhe bilanci vjetor**

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
2. Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

**Neni 28**  
**Shpërndarja e fitimeve**





1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:
  - 1) aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - 2) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

## **KREU VII**

### **RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 29**

#### **Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

1. Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje Shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.
2. Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
3. Likuiduesi/t do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Emërimi i likuiduesit/ëve dhe procesi i likuidimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

## **KREU VIII**

### **MOSMARRËVESHJET**

#### **Neni 30**

#### **Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim dhe marrin këshillim me ndërmjetësimin e një konsulenti ligjor i cili ofron mundësi zgjidhje në interesin më të mirë të secilit prej tyre në takime dhe diskutime të përbashkëta. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetentetë Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

#### **Neni 31**

#### **Dispozita përfundimtare**


1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Ky Akt themelimi-Statut u redaktua në 2 (dy) ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim dhe nen për nen dhe u nënshkrua nga ortakët në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.



3. Ngarkohet administratori Anxhela KOSTA, mbajtëse e kartës së identitetit nr. J55725071U, ose personat e Autorizuar prej tij për të kryer të gjitha procedurat pranë QKB-së për regjistrimin e shoqërisë.

**THEMELUESIT**

**ANXHELA KOSTA**

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized, overlapping letters that appear to be 'AK'.


**NICOLAS MARCEL ADAM**

A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of fluid, connected loops and lines.

**SHTOJCA 1**  
**(ORTAKËT E SHOQËRISË)**

**Znj. Anxhela Kosta**, e bija e Odhise, lindur në Përmet, Shqipëri, më 25.07.1995 dhe banuese në Rrugën Panajot Pano, Nd.6, H.45, Ap.40, Kashar, Yzberisht, Tiranë, shtetase shqiptare, identifikuar me kartën e identitetit me nr. J55725071U, madhore dhe me zotësi të plotë, zotëruese e një kuote me vlerë 500 lekë (pesëqindë), që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.

**Z. Nicolas Adam**, i biri i Ulrich, lindur në Tettngang, Gjermani, më 28.09.1988 dhe banues Alemannen-Strasse 19/2 D-88094 Oberteuringen, Gjermani, shtetas gjerman, identifikuar me kartën e identitetit me nr. L7P37ZHZX, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i një kuote me vlerë 500 lekë (pesëqindë), që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.



**SHTOJCA 2**

**(Specimeni i nënshkrimit të Administratorit)**

Anxhela Josta

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and a final horizontal stroke, positioned below the printed name.